



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu
Komisija za raspodjelu sredstva NVO
Nr./Br. 04-056/23-**4300/2**

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167
veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me
Komisioni për ndarjen e mjeteve OJQ
Tuz – Tuzi, 20.06.2023. godine



Në bazë të neneve 6, 30, 32 dhe 33 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale”, nr. 046/19, 010 /21, 016/21), Komisioni për ndarjen e mjeteve për organizatat joqeveritare, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2023, solli

VENDIM MBI NDARJEN E MJETEVE ORGANIZATAVE JOQEVERIALE PËR VITIN 2023

Neni 1

Buxheti i komunës së Tuzit për vitin 2023 ka ndarë mjete për financimin e projekteve/programeve për organizatat joqeveritare në vlerë prej 30.000.00 euro.
Konkursi publik për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare për vitin 2023 ka përcaktuar mjete në vlerë prej 30.000.00 euro.

Neni 2

Mjete në vlerë prej 30,000,00 euro janë ndarë për organizatat joqeveritare që plotësojnë kushtet e konkursit dhe kriteret nga Vendimi mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare, në bazë të pikëve të përcaktuara nga vlerësues të pavarur, gjegjësisht:

1. OJQ “Zhvillimi i Vranjes”- **4,000.00 €**.
2. OJQ “Xhubleta Malësore”- **5,600.00 €**
3. SHKA “Koha”- **3,800.00 €**
4. SHKA “Liria”- **3,800.00 €**
5. OJQ “Jeta e sigurt Tuz”- **5,900.00 €**
6. OJQ “Shoqata për veprim ndërkulturorë” - **3,800.00 €**
7. OJQ “Qendra Sportive” - **3,100.00 €**

Neni 3

Pjesë përbërëse e Vendimit është edhe ranglista e projekteve të OJQ-ve.

Neni 4

Vendimi mbi ndarjen e mjeteve u dërgohet pjesëmarrësve të Konkursit, publikohet në faqen e internetit të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

Arsyetim

Bazuar në nenin 6 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale”, nr. 046/19, 010 /21, 016/21), kryetari i komunës, me vendimin nr.01-056/ 23-1576/1 prej më 01.03.2023 formoi Komisionin për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat joqeveritare me detyrë kontrollimin e dokumentacionit të pranuar dhe, në përputhje me dispozitat e Vendimit, përcaktimin e rang listës së organizatave joqeveritare që plotësojnë ose jo kushtet për financimin e projekteve të OJQ-ve.

Komisioni për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e masës së mjeteve për organizatat joqeveritare, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 5 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare, i cili përcakton se mjetet nga Buxheti ndahen për organizatat joqeveritare, projektet e të cilave përfshihen në fushën prioritare që lidhet me "Ekologjinë, mbrojtjen e mjedisit", "Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara", "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave", "Mbrojtja sociale dhe e fëmijëve", "Barazia gjinore", "Zgjidhja e problemeve rinore" dhe "Trashëgimia kulturore, duke ushqyer pasuritë historike".

Komisioni për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat joqeveritare i shqyrtoi aplikimet e dorëzuara dhe përcaktoi se cilat organizata joqeveritare i plotësojnë kushtet për ndarjen e mjeteve. Për Konkursin Publik aplikuan 7 (shtatë) organizata joqeveritare me seli në Tuz.

Neni 29 paragrafi 1 i Vendimit për kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 046/19, 010 /21, 016/21) parasheh që në bazë të pikëve të përcaktuara nga vlerësuesit e pavarur, Komisioni të përcaktojë ranglistën e projekteve të vlerësuara.

Neni 30 paragrafi 1 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 046/19, 010 /21, 016/21) parasheh që komisioni të sjellë Vendim mbi ndarjen e mjeteve.

Neni 31 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 046/19, 010 /21, 016/21) përcakton se Vendimi përmban: emrin e organizatave të cilave u janë ndarë mjetet, të dhënat e personave përgjegjës për secilën nga organizatat të cilave u janë ndarë mjetet, emri i projektit, kohëzgjatja e projektit, shuma e mjeteve të ndara nga Komisioni për secilën nga projektet, shuma totale e mjeteve të nevojshme për realizimin e secilit projekt me të dhëna për donatorët e tjerë të mundshëm; shpjegimi i arsyeve të refuzimit, duke përfshirë listën e rezultateve, për të gjitha projektet e refuzuara.

Neni 33 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 046/19, 010 /21, 016/21) përcakton se Vendimi u dërgohet pjesëmarrësve të konkursit në afat prej 8 ditësh nga data e sjelljes, publikohet në faqen e internetit të Komünës, në tabelën e shpalljeve, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen parasheh se vendimi mund të ankimohet te Kryeadministratori.

Pas shqyrtimit të detajuar të Rang listës, Komisioni solli Vendim për shpërndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare për vitin 2023.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv.

UDHËZIM PËR MBROJTJEN JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ankimohet te Kryeadministratori në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit.

Dorëzuar:

- OJQ-së së emëruar;
- Lëndës;
- a/a.

KRYETARJA E KOMISIONIT,
Marina Ujkaj





Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu
Komisija za raspodjelu sredstva NVO
Nr./Br. 04-056/23- *4300/2*

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167
veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me
Komisioni për ndarjen e mjeteve OJQ
Tuz – Tuzi, 20.06.2023. godine



Ranglista e projekteve të OJQ-ve për vitin 2023

Nu mër	Emri OJQ/SHKA	Personi përgjegjës	Kohëzgjatja e projektit	Emri i projektit	Pikët përfundi mtare	Mjetet e kërkuara	Buxheti i korrigjuar
1.	OJQ "Qendra Sportive"	Kristian Gjokaj	28, 29, dhe 30 qershorë	Aktivitet sportiv "Të rinjtë në sport"	50.0	5,350.00	3.100,00
2.	OJQ "Jeta e sigurt Tuz"	Leonora Dukaj	12 muaj	"SOS linja nacionale në gjuhën shqipe për gra, vajza dhe fëmijë me përvojë dhune"	69.5	5,990.00	5.900,00
3.	OJQ "Zhvillimi i Vranjes"	Alen Lekiq	6 muaj	"Të rinjtë duhet të kujdesën për vetën dhe mjedisin e tyre të jetesës"	65.5	5,000.00	4.000,00
4.	OJQ "Xhubleta Malësore"	Shaqe Dushaj	10 muaj	"Adaptimi i punishtës për restaurimin, riparimin dhe ruajtjen e kostumit kombëtar shqiptar"	52.5	5,900.00	5.600,00
5.	SHKA "Koha"	Sulejman Beqaj	27.11. ose 28.11.2023	"Manifestimi me rastin e 28 nëntorit – Dita e flamurit shqiptarë"	56.5	7,500.00	3.800,00
6.	SHKA "Liria"	Admir Nikaj	Od 10.07.- 25.12.2023.g od. .	"Diaspora me ne"	58.0	5,500.00	3.800,00
7.	SHJQ "Shoqata për veprimtari Ndërkulturore"	Senad Alibashiq	5 muaj	"Iniciativa e të rinjeve nga territori i komunës së Tuzit për arsimin, të drejtat e njeriut, problemet sociale dhe bashkëpunimin e mire"	60.0	5,190.00	3.800,00